



A.nr.468/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.468/2026, të datës 23.04.2026, të parashtruar nga ankuesi D.G, kundër organit të punësimit Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në çështjen juridike ‘masë disiplinore’, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 22.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.468/2026 e datës 23.04.2026, e parashtruar nga ankuesi D.G.

II. Anulohet Vërejtja me shkrim e datës 27.03.2026 e shqiptuar nga Sekretari i Përgjithshëm në MAPL përmes emailit ndaj ankuesit.

III. Obligohet Udhëheqësi/ja i NJMBNJ në MAPL që të largoj vërejtjen me shkrim nga dosja personale e ankuesit, brenda 15 ditëve nga dita e pranimi të vendimit sipas pikës II të dispozitivit.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil D.G, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankueses), më datë 27.04.2024, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vërejtjes me shkrim të datës 27.03.2026 të shqiptuar nga Sekretari i Përgjithshëm në MAPL, me pretendime ankimore se Sekretari i Përgjithshëm nuk ka konstatuar saktë gjendjen faktike dhe juridike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek MAPL më datë 04.05.2026, ndërsa kjo e fundit, më datë 06.05.2026 ka përcjellë shkresat e lëndës lidhur me çështjen ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën A.nr.462/2026 të datës 23.04.2026 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtjen me shkrim përmes emailit të datës 27.03.2026; Kopje e letërnjoftimit për ankuesin; Përgjigjen në ankesë të datës 27.04.2026; Emalin e datës 18.03.2026 e dërguar nga Udhëheqësja e NJMBNJ tek B.P; Emalin e datës 18.03.2026 dërguar nga IKAP për mbajtjen e trajnimit; emalin e datës 24.03.2026 dërguar nga B.P tek ankuesi për pjesëmarrje në trajnim; lista e pjesëmarrësve në trajnim në IKAP datë 26,27.03.2026; akt emërimit të datës 30.04.2025; Emalin e datës 24.03.2026 dërguar nga ankuesi me të cilin konfirmon pjesëmarrjen në trajnim.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit D.G, është e bazuar, sepse:

Nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesi sipas akt emërimit të datës 30.04.2025 është e punësuar në pozitën e punës ‘‘Drejtor i Departamentit për Integritet Evropian’’ në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Nga shkresat e lëndës konstatohet kjo gjendje faktike, më datë 18.03.2026 IKAP dërgon ftesë në shumë institucione tek NJMBNJ për mbajtjen e trajnimit me temën ‘‘Bashkimi Evropian legjislativ, institucionet dhe vendimmarrja në BE’’, në të njëjtën datë Udhëheqja e NJMBNJ këtë email e dërgon tek Zyrtari i Personelit B.P, ky i fundit më datë 24.03.2026 cakton për të marrë pjesë në trajnim sipas fushës që mbulon trajnimi Drejtorin e Departamentit për Integritet dhe Koordinim të Politikave. Në vazhdim të komunikimeve ankuesi më datë 24.03.2026 konfirmon pjesëmarrjen në trajnim tek zyrtarja e IKAP duke njoftuar edhe zyrtarin e Personeli BP se do të marrë pjesë në trajnim më datë 26,27.03.2026.

Ngase u tha më lartë për përcaktimin e lirshmërisë së veprimit ndaj ankuesit Kolegji, ju referuar LZP Nr.08/L-197 respektivisht neni 16 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 ku përcaktohet se ‘‘2. **Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka këto kompetenca:** 2.4. identifikon dhe vlerëson, në koordinim me udhëheqësen/in e njësisë në mënyrë periodike, nevojat për trajnim të nëpunësve/eve civil të institucionit për aftësimin dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve për zhvillimit profesional;, si dhe neni 26 paragrafi 1 ku përcaktohet se ‘‘ E drejta e aftësimin profesional 1. Zyrtarja/i publik ka të drejtë të zhvillojë aftësitë dhe njohuritë profesionale për vendin e punës, përmes aftësimin profesional dhe trajnimeve të vazhdueshme, të financuara nga fondet publike, nga donatorë të huaj apo nga të ardhurat vetanake, në rast se kjo nuk bie në kundërshtim me legjislacionin përkatës në fuqi’’, prandaj në bindjen e Kolegjit ankuesi ka qenë në koordinim të plotë me NJMBNJ për të marrë pjesë, ndërsa NJMBNJ ka qenë e obliguar ta njoftoj Sekretarin e Përgjithshëm për dërgimin e ankuesit, sepse dispozita më lartë sqaron saktë që NJMBNJ duhet me qenë në koordinim me Udhëheqësin e nëpunësve civil sa i përket trajnimeve dhe ngritjes profesionale.

Gjithashtu Sekretari Përgjithshëm kur ka shqiptuar vërejtjen me shkrim me datë 27.03.2026 ka konstatuar citoj; Nga ora 10:45, jeni ftuar në takim me stafin menagjerial.....” kjo nënkuptohet se SP në MAPL i ka shqiptuar vërejtje me shkrim ankuesit vetëm për datë 27.03.2026 duke u thirrur në mungesën në punë edhe pse ankuesi siç është sqaruar në këtë arsyetim më lartë ka qenë në trajnim zyrtar.

Kolegji i Këshillit konstaton se SP në MAPL gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale që rregullon këtë fushë për arsye, për tu konsideruar shkelje e lehtë mungesa nga punë duhet të jetë dy ditë radhazi, ndërsa SP në MAPL i shqipton vërejtje me shkrim vetëm për datës 27.03.2027 dhe me këtë veprim bie në kundërshtim me nenin 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2 dhe paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 ku përcaktohet se” 1. Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësisë të punës mund të jenë: 1.1. *shkelje të lehta*; 1.2. *shkelje të rënda*. 2. *Shkeljet e rënda të detyrave dhe përgjegjësisë të punës janë të përcaktuara me ligj, ndërsa shkeljet e lehta janë të përcaktuara me ligj dhe rregulla të brendshme*. 3. Shkelje të lehta konsiderohen: 3.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune radhazi;

Prandaj në dritën e thënieve më lartë Kolegji konstaton se Vërejtja me shkrim e datës 27.03.2026 është marrë në kundërshtim me LPP Nr.05/L-031 respektivisht neni 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6 dhe paragrafi 2 ku përcaktohet se “Arsyetimi i një akti administrativ me shkrim 1. *Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban:* 1.1. *paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës*; 1.2. *shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi*; 1.3. *shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave*; 1.4. *bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret*; 1.5. *shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve*; 1.6. *në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim*. 2. **Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.**”

Kështu që për sa me sipër dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA, A.nr.468/2026

Ilire Mehmeti Shaqiri

Eshref Shabani

Procesmbajtëse

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit D.G;
- Sekretarit të Përgjithshëm si dhe Njesisë për Burime Njerëzore në MAPL; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.